
PROJEKTI I MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

E.H.W sh.p.k.
Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

Beta Invest sh.p.k.
Si Shoqëri e Përthithur

- a. E.H.W. sh.p.k. Nr. ___ Prot. Tiranë, më 31/10/2016
b. Beta Invest sh.p.k. Nr. ___ Prot. Tiranë, më 31/10/2016

PROJEKT BASHKIMI ME PËRTHITHJE I BETA INVEST SH.P.K. NGA E.H.W. SH.P.K.

Ky projekt bashkimi me përthithje është hartuar nga:

- Administratori i shoqërisë E.H.W. sh.p.k. Z. Luan Leka dhe
- Administratori i shoqërisë Beta Invest sh.p.k. Znj. Melika Leka

Ky projekt është iniciuar nga ortakët e shoqërisë E.H.W. sh.p.k. për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të Beta Investsh.p.k nga E.H.W. sh.p.k.

1. **E.H.W sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital të regjistruar prej 500,000,000 lekë, i ndarë në 2 kuota, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Superstradën Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë dhe krijuar me vendimin e gjykatës Tiranë nr. 21525 datë 04.11.1992, e perfaqësuar nga administratori i shoqërisë Z. Luan Leka, që për qëllim të kësaj marrëveshje E.H.W. sh.p.k. do të quhet "**Shoqëria Përthithëse**".

dhe

2. **Beta Invest sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital themeltar të regjistruar prej 43,400,000 lekë, i përbërë nga një 1 kuotë, i zotëruar tërësisht nga E.H.W Sh.p.k., tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Superstradën Tiranë-Durrës, km 8, në ambjentet e E.H.W sh.p.k., Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë në 05.10.2011, e përfaqësuar nga administratorja ligjore znj. Melika Leka që për qëllim të kësaj marrëveshje Beta Invest sh.p.k. do të quhet "**Shoqëria e Përthithur**".

DEKLARATA PARAPRAKE

- A. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Pjesa IX, Neni 215 deri tek Neni 225, me propozim të Administratorit të shoqërisë E.H.W sh.p.k. hartohet kjo Projekt-Marrëveshje për Bashkimin me përthithje të Beta Invest sh.p.k. nga E.H.W sh.p.k.
- B. Duke qënë se E.H.W sh.p.k. nga data 05.05.2016 është zotëruese në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë Beta Invest sh.p.k.
- C. Bashkimi ka si qëllim rritjen e performancës ekonomike të Shoqërisë E.H.W sh.p.k. në përputhje me objektivat e Shoqërisë, si dhe uljen e kostove të administrimit të shoqërisë Beta Invest sh.p.k, të cilat do të përmirësojnë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve.
- D. E.H.W sh.p.k. dhe Beta Invest sh.p.k. dëshirojnë të kryejnë një Bashkim nëpërmjet të cilit E.H.W sh.p.k. do të përthithë shoqërinë Beta Invest sh.p.k. dhe shoqëria E.H.W sh.p.k. do të vazhdojë aktivitetin ndërsa Beta Invest sh.p.k. do të çregjistrohet pa kaluar në likuidim.
- E. Më datë 31.10.2016 Z. Luan Leka dhe znj. Melika Leka në cilësinë e ortakëve të shoqërisë E.H.W sh.p.k. kanë rënë dakord të: Fillohen procedurat për bashkimin nëpërmjet përthithjes të

shoqërisë Beta Invest sh.p.k. nga shoqëria E.H.W sh.p.k. dhe është ngarkuar administratori i shoqërisë E.H.W. Sh.p.k. për përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje

- F. Me Vendimin date 31.10.2016 të Ortakut të Vetëm të shoqërisë Beta Invest sh.p.k. është miratuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë Beta Invest sh.p.k. me shoqërine E.H.W sh.p.k. dhe është ngarkuar administratori i shoqërisë E.H.W. Sh.p.k. për përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje.
- G. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë marrëveshje në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e tre drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e Bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Marrëveshje, përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“**Marrëveshje**” nënkupton këtë Marrëveshje.

“**Shoqëri Përthithese**” në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria E.H.W sh.p.k.

“**Shoqëri e Përthithur**” në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria Beta Invest sh.p.k.

“**Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit**” ose “**Data Efektive e Bashkimit**” ose “**Data e Ekzekutimit**” ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.1 të kësaj Marrëveshje, që do të thotë data e regjistrimit të Mbylljes së Bashkimit me Përthithje pranë regjistrarit Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 220, paragrafi 3 i Ligjit Tregtar.

“**Informacion konfidencial**” nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive E.H.W sh.p.k. dhe Beta Invest sh.p.k.

“**Mbyllja**” do të thotë mbyllja e bashkimit mes E.H.W. Sh.p.k. dhe Beta Invest Sh.p.k., si edhe më gjërësisht, nënshkrimi dhe shkëmbimi i të gjithë dokumenteve dhe përmbushja e plotësimi i të gjithë detyrimeve përkatëse që kërkohen të nënshkruhen, shkëmbehen, kryen dhe konsumohen në Mbyllje sipas neneve 9 dhe 10 të kësaj Marrëveshje në mënyrë që Bashkimi me Përthithje të kryhet rregullisht.

“**Data e Mbylljes**” do të thotë data në të cilën do të kryhet Mbyllja në përputhje me nenin 10.1.

“**Qendra Kombëtare e Biznesit**” ose “**QKB**” nënkupton njësinë administrative të themeluar në bazë të Ligjit nr. 9723, datë 03.04.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar.

“**Data e nënshkrimit**” nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshje nga të dyja palët, ashtu siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj Marrëveshje.

“Data e Fundit Kontabel” do të thotë data 31 dhjetor 2015;

“Ligji Tregtar” do të thotë Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

“Regjistri Tregtar” do të thotë Regjistri Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;

“Periudha Kalimtare” do të thotë periudha kohore nga data [e miratimit nga asamblete perkatese te dy shoqerive te projektit te bashkimit] deri në Mbyllje, gjatë së cilës E.H.W. dhe Beta Invest do të kryejnë një tërësi veprimesh me qëllim përmbushjen e transaksionit të Bashkimit me Përthithje.

Neni 2

BASHKIMI, KËMBIMI I KUOTAVE DHE DATA KONTABËL

- 2.1 Përthithja do të kryhet me efekt *in rem*, në datën e regjistrimit të Mbylljes pranë Regjistrat Tregtar të QKB-së, në përputhje me nenin 220, paragrafi 3 të Ligjit Tregtar.
- 2.2 Bashkimi me Përthithje do të bazohet në bilancet e Beta Invest dhe E.H.W.-së të datës 31 dhjetor 2015, e cila është Data e Fundit Kontabël.
- 2.3 Beta Invest sh.p.k. do t'i transferojë shoqërisë E.H.W sh.p.k. tërësinë e elementeve të aktivitetit të pasivitetit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën e Mbylljes.
- 2.4 Si rezultat i operacionit të Bashkimit, duke qenë se nga data 05.05.2016 E.H.W është zotëruese e 100% të kapitalit të Beta Invest, kapitali i nënshkruar i E.H.W-së në Datën e Mbylljes mbetet i njëjtë me kapitalin para bashkimit. Kapitali themeltar i Beta Invest netohet në bilancin e konsoliduar të të dy shoqërive me vlerën e pjesëmarrjes.
- 2.5 Bilanci i Hapjes i Shoqërisë Përthithëse në Datën e Ekzekutimit, do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Dates së Fundit Kontabël të të dy shoqërive, përpara Përthithjes (“**Bilanci i Hapjes së Bashkimit me Përthithje**”), këtu bashkëlidhur kësaj Marrëveshje. Çdo ndryshim dhe korigjim i mundshëm i kryer midis Datës së Fundit Kontabël dhe Datës së Mbylljes, i cili nuk është përfshirë në këtë Bilanc, do të pasqyrohet në raportin e administratorit të E.H.W.-së që do të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të E.H.W.-së, ose në dokumentet e Mbylljes, sipas rastit.
- 2.6 Të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga Beta Invest sh.p.k. përgjatë Periudhës Kalimtare do të konsiderohen si të kryera nga E.H.W sh.p.k.
- 2.7 Statuti i shoqërisë E.H.W. sh.p.k. pas ndryshimeve që do t'i bëhen në objektin e veprimtarisë do të vazhdojë të jetë edhe statuti i Shoqërisë Përthithëse.
- 2.8 Anëtarët e Organeve drejtuese të Shoqërisë E.H.W sh.p.k. në Datën e Mbylljes do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.
- 2.9 Administrator i Shoqërisë Përthithëse do të jetë Z. Luan Leka i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të Shoqërisë Përthithëse sipas Ligjit Tregtar dhe statutit të saj.



Neni 3

AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

3.1 Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që Beta Invest sh.p.k t'i transferojë shoqërisë E.H.W. sh.p.k. tërësinë e elementeve të aktivitetit të pasivitetit gjendje më datë 31.12.2015.

3.2 Grupet kryesore të këtyre aktiveve dhe pasiveve më datë 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2015 që janë marrë si bazë për hartimin e Marrëveshjes së Bashkimit paraqiten si vijon:

BETA INVEST SH.P.K.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	1,125,854	1,445,570
Kapital i paderdhur	-	3,787,333
Të tjera llogari të arkëtueshme	6,000	6,000
Total aktive afatshkurtra	1,131,854	5,238,903
Aktivet afatgjata		
Aktive financiare	114,005,760	36,851,760
Total aktive afatgjata	114,005,760	36,851,760
Total aktive	115,137,614	42,090,663
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Hua të tjera	71,891,250	174,240
Detyrime ndaj punonjësve	667,774	491,400
Detyrime tatimore	374	-
Total detyrime afatshkurtra	72,559,398	665,640
Detyrime afatgjata		
Total detyrime afatgjata	-	-
Totali i detyrimeve	72,559,398	665,640
KAPITALI		
Kapitali i nënshkruar	43,400,000	43,400,000

Fitime të mbartura	(1,974,977)	(1,346,906)
Fitimi i ushtrimit	1,153,193	(628,071)
Total kapitali	42,578,216	41,425,023
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	115,137,614	42,090,663

3.3 Ndërkohë të dhënat e bilancit të E.H.W sh.p.k. më datë 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 që janë marrë si bazë për hartimin e Marrëveshjes së Bashkimit janë si më poshtë:

E.H.W SH.P.K.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale		365,338,030	340,042,028
Aktivet afatgjata jomateriale		955,238	1,367,013
Parapagime për aktive afatgjata materiale		11,123,730	
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		100,000	100,000
Total aktive afatgjata		377,516,998	341,509,041
Aktivet afatshkurtra			
Inventari		213,903,397	188,649,678
Llogari të arkëtueshme tregtare		77,346,546	89,829,408
Llogari të arkëtueshme të tjera		5,850,258	202,966
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		17,441,927	7,906,348
Mjetet monetare në arkë e në bankë		148,170,269	196,667,525
Total aktive afatshkurtra		462,712,397	483,255,925
Total Aktive		840,229,395	824,764,966
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		500,000,000	500,000,000
Rezerva ligjore		49,598,660	45,928,727
Fitime/humbje të mbartura		4,559,465	3,582,637
Fitim/humbje e vitit		102,599,341	73,398,661
Total kapitali		656,757,466	622,910,025
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Total detyrime afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		-	-
Llogari të pagueshme tregtare		119,098,256	112,705,359
Detyrime tatimore		19,278,854	7,263,352
Detyrime ndaj punonjësve		9,776,179	5,797,430

Llogari të pagueshme të tjera	35,318,640	76,088,800
Total detyrime afatshkurtra	183,471,929	201,854,941
Totali i detyrimeve	183,471,929	201,854,941
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	840,229,395	824,764,966

3.4 Pas realizimit të operacionit të bashkimit të dhënat e bilancit të konsoliduar të **E.H.W sh.p.k.** me bilancin e **Beta Invest Sh.p.k.**, më datë 31.12.2015 (në Datën e Fundit Kontabël), pas bashkimit me përthithje paraqiten si më poshtë:

	Shenime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale		365,338,030	340,042,028
Aktivet afatgjata jomateriale		955,238	1,367,013
Parapagime për aktive afatgjata materiale		11,123,730	-
<u>Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara</u>		<u>114,105,760</u>	<u>36,951,760</u>
Total aktiveve afatgjata		491,522,758	378,360,801
Aktivet afatshkurtra			
Inventari		213,903,397	188,649,678
Llogari të arkëtueshme tregtare		77,346,546	89,829,408
Llogari të arkëtueshme të tjera		5,856,258	208,966
Kapital i paderdhur		-	3,787,333
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		17,441,927	7,906,348
<u>Mjetet monetare në arkë e në bankë</u>		<u>149,296,123</u>	<u>198,113,095</u>
Total aktive afatshkurtra		463,844,251	488,494,828
Total Aktive		995,367,009	866,855,629
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		500,000,000	500,000,000
Rezerva kapitali		43,400,000	43,400,000
Rezerva ligjore		49,598,660	45,928,727
Fitime/humbje të mbartura		2,584,488	2,235,731
<u>Fitim/humbje e vitit</u>		<u>103,752,534</u>	<u>72,770,590</u>
Total kapitali		699,335,682	664,335,048
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
<u>Hua afatgjata</u>		<u>-</u>	<u>-</u>
Total detyrime afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		71,891,250	-
Llogari e pagueshme tregtare		119,098,256	112,879,599
Detyrime tatimore		19,279,228	7,263,352
Detyrime ndaj punonjesve		10,443,953	6,288,830
Llogari te pagueshme te tjera		35,318,640	76,088,800
Total detyrime afatshkurtra		256,031,327	202,520,581
Totali i detyrimeve		256,031,327	202,520,581
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		995,367,009	866,855,629

Neni 4

MODALITETET

4.1 E.H.W. sh.p.k. do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Beta Invest sh.p.k. në Datën Efektive të Bashkimit.

4.2 E.H.W. sh.p.k. në Datën Efektive të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licencat e zotëruara nga Beta Invest sh.p.k. në këtë datë.

4.3 Shoqëria Beta Invest sh.p.k. nuk ka asnjë punonjës që do të transferohet tek E.H.W. sh.p.k.

Neni 5

GARANCITË PËR KREDITORËT DHE MBROJTJA E TYRE

5.1 Palët e kësaj procedure bashkimi me përthithje garantojnë kreditorët e shoqërive të përfshira në këtë Bashkim, sidomos ata të Shoqërisë së Përthithur se detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen automatikisht Shoqërisë Përthithese E.H.W. sh.p.k., përfshirë huatë që:

- i. **Z. Luan Leka** i ka dhënë shoqërisë Beta Invest sh.p.k. në kohën kur ishte ortak i saj, në shumën prej 35,945,625.00 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) Lekë, të cilën Beta Invest sh.p.k. ende nuk ia ka kthyer Z. Leka ("**Huaja Luan Leka**"), dhe
- ii. **Znj. Melika Leka** i ka dhënë shoqërisë Beta Invest sh.p.k. në kohën kur ishte ortak e saj, në shumën prej 35,945,625.00 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) Lekë, të cilën Beta Invest sh.p.k. ende nuk ia ka kthyer Znj. Leka ("**Huaja Melika Leka**")

5.2 Shoqëria Përthithese merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e Shoqërisë së Përthithur në marrëdhënie me të tretet, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e Shoqërisë së Përthithur t'i drejtojnë pretendimet e tyre ndaj Shoqërisë Përthithese, përfshirë edhe: (i) ndaj Z. Leka në lidhje me Huanë Luan Leka dhe (ii) ndaj Znj. Leka në lidhje me Huanë Melika Leka.

Neni 6

RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që Beta Invest sh.p.k. nga data 05.05.2016 zotërohet 100% nga E.H.W. sh.p.k., nuk ka raporte të këmbimit të kapitalit.

Neni 7

SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

Neni 8

TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Neni 9

PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në Datën e Mbylljes, Palët duhet që:

- a) Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Marrëveshje si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
- b) Të ndërmarrin çdo veprim për depozitim e të gjitha dokumentave në QKB.

Neni 10

MBYLLJA E OPERACIONIT

10.1 Mbyllja e operacionit të Bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë E.H.W. sh.p.k. në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë, sa më shpejt të jetë e mundur.

10.2 Në Mbyllje, ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:

- a) Të gjithë vendimet e ortakëve të secilës shoqëri në lidhje me këtë operacion;
- b) Njoftimet përkatëse në zyrat e tatimeve në lidhje me operacionin e mësipërm.

Neni 11

DEKLARIMET DHE GARANCITE

11.1 Deklarimet dhe Garancite e E.H.W. sh.p.k.:

- E.H.W. sh.p.k. dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- E.H.W. sh.p.k. nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrimje ose në proces likuidimi.

11.2 Deklarimet dhe Garancite e Beta Invest sh.p.k.:

- Beta Invest sh.p.k. dhe përfaqësuesja e saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.
- Beta Invest sh.p.k. nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrimje ose në proces likuidimi.

Neni 12

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

12.1 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë para Datës së Mbylljes me miratimin me shkrim të të dy Paleve.

12.2 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet nga secila Palë me anë të njoftimit me shkrim tek Pala tjetër, para Datës së Mbylljes, nëse Bashkimi nuk përfundon.

Neni 13

KONFIDENCIALITETI

13.1 Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përfuara si rezultat i nisjes dhe përbushjes së kësaj Marrëveshje, të cilat kanë lidhje me negociatat, përbushjen dhe mbylljen e kësaj Marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo Marrëveshje.

13.2 Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

- a) Kërkohej nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore;
- b) Kërkohej nga ndonjë institucion qeveritar;
- c) Me miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

Neni 14

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Marrëveshje rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

TË NRYSHME

15.1 Shpenzimet

Shoqëria Përthithëse do të marrë përsiper shpenzimet në lidhje me negociimet, zbatimin dhe Mbylljen e çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për Përthithjen.

15.2 Tërësia e Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje (bashke me dokumentet tek të cilat referon ose që janë zbatuar përpara ose në çastin e Mbylljes) përben Marrëveshjen në tërësi dhe marrëveshjen mes Palëve, zëvendëson dhe ka përparësi ndaj çdo marrëveshje, rregullimi apo ndërmarrjeje të mëparshme të Palëve në lidhje me këtë çështje.

15.3 Ndryshimet në Marrëveshje

Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga Palët.

15.4 Pavlefshmëria e pjeshme

Në rast se një pjesë e kësaj Marrëveshje është/ose shpallet e pavlefshme ose jo detyruese, pjesa tjetër mbetet e vlefshme dhe e detyruese për Palët. Në këtë rast, Palët zëvendësojnë dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese me dispozita të vlefshme dhe detyruese, efekti i të cilave, për aq sa është e mundur, është sa më i afërt me dispozitat e pavlefshme ose jo detyruese duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshje.

15.5 Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara apo dhe të lejuara nga kjo Marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresën si më poshtë vijon, derisa Palët të njoftojnë njëri-tjetrin për ndryshime të adresave të tyre.

Për E.H.W. sh.p.k.:

Autostrada Tiranë-Durrës , km 8 Tiranë
Në vëmendje të: Z. Luan Leka

Për Beta Invest sh.p.k.:

Autostrada Tiranë-Durrës , km 8 Tiranë
Në vëmendje të: Znj. Melika Leka

Kjo Marrëveshje u hartua dhe u nënshkrua sot më datë 31.10.2016, në 6 kopje origjinale nga:

PALËT

Shoqëria

E.H.W. sh.p.k.

Përfaqësuar nga:



Z.Luan Leka
Administrator



Shoqëria

Beta Invest sh.p.k.

Përfaqësuar nga:



Znj.Melika Leka
Administrator

